



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja, nr. 05

Prishtinë, më 11.6.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selvije Halimi, Albulena Haxhiu, Danush Ademi dhe Enver Hoti.

Munguan: Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Xheladin Hoxha – Drejtor në DMKP, Blerta Bejtullahu – URSR/Office, Naim Jakaj – GP VV, Shefki Kastrati – NDI, Visar Rushiti – GAP, Kaltrina Ahmeti – GLPS, Rinor Beka – NDI, Valmire Hoti- Info direkt. TV, Dea Rodiqi – UNDEP, Etleva Ikonja – Kosova Sot, Floriana Shala – OSBE, Erdi Pirana dhe Gentiana Dushi-praktikant.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryetari tha se edhe gjatë këtij takimi do të diskutohen ato dispozita për të cilat kemi dilema dhe rikujtoi se pas shqyrtimit të këtij drafti, në punëtori do të vendoset për tekstin final që do t'i procedohet Komisionit për miratim dhe procedim për mendim në Qeveri. Ai njoftoi anëtarët që nuk kanë qenë prezent në takimet e kaluara me ndryshimet e bëra dhe kërkoi që të vazhdohet aty ku kemi mbetur.

Albulena Haxhiu propozoi që si kapitulli për procesin e integritetit evropian që i është proceduar Komisionit për integritet për komente do ishte mirë edhe kapitulli për pavarësinë buxhetore të Kuvendit t'i dërgohet për komente komisionit për buxhet dhe financa. Ajo, po ashtu, i njoftoi anëtarët se është kërkuar nga kryesia që si Komision ta kemi gati Projektligjin për Kuvendin dhe rregulloren e punës gjatë sesionit pranveror.

Gjatë këtij takimi Nënkomisioni vazhdoi me shqyrtim të dispozitave nga neni 18 deri te neni 27. Ishte akordim i përgjithshëm që nenin 18, paragrafi 1 të riformulohet si vijon” Deputeti i Kuvendit (në tekstin e mëtejshëm: deputeti) gëzon status të veçantë gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit në pajtim me dispozitat kushtetuese, ligjet dhe rregulloren.” Neni 19 dhe 20 fuzionohen dhe riformulohen duke marrë për bazë ligjin bazik për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit. Ishte i diskutueshëm fillimi i mandatit i deputetit, pasi është edhe kategori kushtetuese ku pas shumë mendimesh lidhur me fillimin e mandatit, ishte një akordim i përgjithshëm që neni 21 të riformulohet si vijon” Mandati i deputetit fillon ditën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.”

3. Të ndryshme.

Takimi i radhës së Nënkomisionit u caktua më 15.6.2015, në orën 12:00.

Mbledhja përfundoi në orën 10:05.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj